

# suva



## Të siguruar në mbarë botën?

Udhëtim të mbarë me sigurimin «Suva» për aksidentet jashtë vendit të punës dhe jashtë vendit

# Sigurimi i aksidenteve jashtë vendit të punës dhe jashtë vendit

## Kushtet dhe përfitimet e sigurimit

### Kushtet për mbulimin e sigurimit

#### Parimi

Punëmarrësi duhet të jetë i siguruar nga aksidentet jashtë vendit të punës në momentin e aksidentit.

#### Kush është i siguruar?

Të gjithë punëmarrësit që punojnë të paktën 8 orë në javë me një punëdhënës janë të siguruar nga aksidentet jashtë vendit të punës.

#### Kohëzgjatja e sigurimit të aksidenteve jashtë vendit të punës

Sigurimi i aksidenteve jashtë vendit të punës përfundon në ditën e 31-të pas ditës në të cilën përfundon e drejta për të paktën gjysmën e pagës; mund të zgjatet deri në 6 muaj rresht duke lidhur një marrëveshje të veçantë sigurimi.

Primi është 65 franga në muaj. Kjo shumë vlen edhe për muajt e nisur kalendarikë. Lehtë dhe shpejt sigurimi mund të lidhet dhe të paguhet në internet në [www.suva.ch/abredeversicherung](http://www.suva.ch/abredeversicherung). Të siguruarit marrin një certifikatë sigurimi që mund të përdoret ndërkombëtarisht.

### Fusha e mbulimit të sigurimit

Kushdo që është i siguruar nga aksidentet jashtë vendit të punës gëzon edhe mbulimin e sigurimit «Suva» në udhëtimet e pushimeve jashtë vendit.

## Përfitimet e sigurimit

### Shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe rimbursimet e kostos

#### Vend me marrëveshje sigurimesh shoqërore

Zvicra ka lidhur marrëveshje me BE-në dhe EFTA-n. Këto prekin të gjitha vendet anëtare të dy konfederatave të shteteve. Ekzistojnë gjithashtu marrëveshje të veçanta të sigurimeve shoqërore midis Zvicrës dhe Maqedonisë, Turqisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë.

Në të gjitha këto vende, «Suva» rimbursion shpenzimet në përputhje me legjislacionin e shtetit përkatës.

#### Vend pa marrëveshje sigurimesh shoqërore

Në një shtet që nuk ka marrëveshje për sigurimet shoqërore, «Suva» paguan shpenzimet e trajtimit mjekësor (ambulator ose spitalor) deri në dyfishin e shpenzimeve që do të ishin bërë në Zvicër. Në shumë prej këtyre vendeve, megjithatë, mbulimi i sigurimit nga «Suva» nuk është i mjaftueshëm.

Në rastin e masave të shpëtimit dhe rikuperimit, si dhe për udhëtimin dhe transportin e nevojshëm mjekësor, shpenzimet në përgjithësi rimbursohen deri në një të pestën e shumës maksimale të pagës së siguruar, e cila aktualisht nuk i kalon 29640 franga.

Prandaj, ju rekomandojmë shumë që të merrni sigurim privat suplementar.

#### Përfitimet në para

Fakti që aksidenti ka ndodhur jashtë vendit nuk e kufizon të drejtën e të siguruarit ose të familjarëve të tij për përfitime në para (kompensim ditor, pensione, kompensime të pafuqisë dhe integritetit, kompensime të inflacionit).

Për llogaritjen e kompensimit ditor, paga e siguruar është paga e fundit e marrë para aksidentit, ndërsa për llogaritjen e pensioneve, paga e marrë brenda një viti para aksidentit.

Shuma maksimale e pagës së siguruar vendosur nga Këshilli Federal është aktualisht 148200 franga në vit dhe 406 franga në ditë kalendarike.

# Çfarë duhet të dini

## Dhe çfarë duhet të bëni nëse është e nevojshme

### Rreziqet e përjashtuara plotësisht ose pjesërisht nga sigurimi

Dispozitat ligjore për reduktimin dhe refuzimin e përfitimeve të sigurimit në përgjithësi dhe në rastin e rrezikut dhe neglizhencës së rëndë në veçanti zbatohen edhe për aksidentet jashtë vendit. Ata që duan të marrin përsipër rreziqe të mëdha sportive, të tilla si ekspedita ngjitjeje etj., duhet të pyesin përpara nisjes në qendrën përgjegjëse të kompetencës për dëmin (shiko fq. 6), nëse sporti në fjalë ose mënyra se si ushtrohet ai është plotësisht i siguruar. Bashkëpunëtorët tanë do të jenë të lumtur të japin informacion për këtë dhe, sipas kërkesës, edhe për arsyet e tjera të reduktimit dhe përjashtimit. Shihni gjithashtu: [www.suva.ch/wagnisse](http://www.suva.ch/wagnisse)

### Sjellja në rast aksidenti jashtë vendit

#### Asistenca nga «Suva»

«Suva» është gjithashtu aty për të siguruarit e saj jashtë vendit: falë asistencës. Ky shërbim i dobishëm nga «Suva» është në përputhje me kujdesin holistik dhe mbrojtjen gjithëpërfshirëse që «Suva» u ofron të siguruarve të saj.

Me asistencën, të gjithë të siguruarit e «Suva» mund të mbështeten në ndihmën mjekësore, mbrojtjen dhe këshillat gjatë qëndrimeve të përkohshme jashtë vendit. Kjo përfshin linjën e ndihmës 24-orëshe, një rrjet mbarëbotëror të kujdesit mjekësor, kujdesin dhe pagesat paraprake si shpenzimet e mjekut, barnave dhe spitalit në vend, si dhe transportin në një klinikë të besuar ose transportin e kthimit në shtëpi.

Nëse keni nevojë për ndihmë jashtë vendit: telefononi numrin e asistencës +41 848 724 144.

Asistenca ofrohet gjithashtu për telefonat inteligjentë ose tabletët (Android dhe iOS): Informacioni për këtë disponohet në [www.suva.ch/assistance](http://www.suva.ch/assistance)

### **Raportimi i aksidentit**

Njoftoni sa më shpejt që të jetë e mundur punëdhënësin/punëdhënësen tuaj, në mënyrë që personat përgjegjës në kompaninë tuaj të bëjnë njoftimin për dëmin te «Suva». Të gjitha informacionet për njoftimin për dëmin i gjeni në [www.suva.ch/schadenmeldung](http://www.suva.ch/schadenmeldung). Nëse personat përgjegjës në kompaninë tuaj nuk janë të disponueshëm, atëherë kontaktoni direkt në qendrën përgjegjëse të kompetencës për dëmin te «Suva» (shiko fq. 6).

### **Vërtetim mjekësor**

Sa herë që është e mundur, formulari «Vërtetim mjekësor» duhet të plotësohet nga mjeku që ju ndjek dhe duhet të dërgohet menjëherë te «Suva».

### **Pagesa e faturave**

#### **BE/EFTA dhe vendet me marrëveshje të sigurimeve shoqërore në fushën e sigurimit nga aksidentet**

Nëse aksidenti ka ndodhur brenda BE-së ose EFTA-s, kostot e trajtimit mjekësor rimbursohen sipas tarifës sociale të vendit përkatës dhe paguhen nëpërmjet zyrës përkatëse të ndërlidhjes. Nëse i siguruari është trajtuar në pavijonin privat të një spitali publik ose në një klinikë private, mund t'i duhet të përballojë vetë çdo kosto shtesë që i është faturuar.

Nëse aksidenti ka ndodhur në një shtet që ka marrëveshje të sigurimeve shoqërore, «Suva» e paguan trajtimin me tarifën sociale të atij shteti. Palët që faturojnë duhet të jenë të vetëdijshme që aplikohet tarifa e sigurimeve shoqërore e vlefshme në këtë shtet.

«Suva» rekomandon pagesën direkt të faturave me shumë të vogla dhe dërgimin e faturave të paguara për rimbursim. Nëse i siguruari është trajtuar në pavijonin privat të një spitali publik, në një klinikë private ose nga një mjek privat, ai duhet të përballojë vetë shpenzimet shtesë që i janë faturuar.

#### **Shtetet pa marrëveshje të sigurimeve shoqërore**

Nëse aksidenti nuk ndodh në BE ose EFTA dhe jo në një shtet me marrëveshje të sigurimeve shoqërore, «Suva» do t'i rimbursojë të siguarit maksimumi dyfishin e shumës së shpenzimeve që do të ishin bërë për trajtimin në Zvicër.

# Numrat më të rëndësishëm të telefonit

## Në rast dëmi

Qendra jonë e kompetencës për dëmin është e ndarë në katër rajone dhe u përgjigjet pyetjeve të klientëve në lidhje me aksidentet dhe shërbimet.

## Rajoni qendror

Kantonet AG, BE, BS, BL, LU, NW, OW, SO, UR, ZG  
Tel. +41 58 411 12 13  
suva.mitte@suva.ch

## Rajoni lindor

Kantonet AI, AR, GL, GR, SG, SH, SZ, TG, ZH  
Tel. +41 58 411 12 14  
suva.ost@suva.ch

## Rajoni jugor

Kantoni Tessin  
Tel. +41 58 411 12 15  
suva.sud@suva.ch

## Rajoni perëndimor

Kantonet FR, GE, JU, NE, VD, VS  
Tel. +41 58 411 12 16  
suva.ouest@suva.ch

## Për informacione të përgjithshme

Për informacione të përgjithshme zgjidhni:  
Tel. +41 58 411 12 12  
Internet: [www.suva.ch](http://www.suva.ch)

## Ndihma jashtë vendit

Zgjidhni linjën telefonike për ndihmë 24 orë  
+41 848 724 144.



## Modeli «Suva» Katër shtyllat



«Suva» është më shumë se një kompani siguri-mesh; ajo ndërthur parandalimin, sigurimin dhe rehabilitimin.



«Suva» ia kthen teprica të siguruarve në formën e primeve më të ulëta.



«Suva» menaxhohet nga partnerë socialë. Përbërja e balancuar e Këshillit «Suva», e përbërë nga përfaqësues të punëdhënësve, punëmarrësve dhe qeverisë federale, mundëson zgjidhje me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme.



«Suva» është e pavarur dhe nuk merr fonde publike.

## Kjo broshurë duhet të jetë pjesë e bagazhit tuaj

### Ju urojmë një udhëtim të këndshëm.

«Suva» shpreson që kjo broshurë do t'ju shoqërojë në udhëtimin tuaj të radhës jashtë vendit. Kjo broshurë përmban informacione të rëndësishme se si të veprohet pas një aksidenti që rezulton me lëndim apo edhe vdekje, në mënyrë që të kërkohen përfitimet e «Suva» sa më shpejt që të jetë e mundur. Ju urojmë një qëndrim të këndshëm dhe mbi të gjitha pa aksidente jashtë vendit.

#### Suva

Postfach, 6200 Luzern  
Tel. 058 411 12 12  
[www.suva.ch/2154.sq](http://www.suva.ch/2154.sq)

Botimi: Nëntor 2024

#### Numri i publikimit

2154.sq  
(në dispozicion vetëm si PDF)

**Numri i asistencës, nëse keni nevojë për ndihmë jashtë vendit:**

**+41 848 724 144.**

Pritni kartën e asistencës dhe mbajeni në portofolin tuaj. Asistenca është gjithashtu e disponueshme për telefonat inteligjentë ose tabletët (Android dhe iOS). Informacioni ofrohet në:

[www.suva.ch/assistance](http://www.suva.ch/assistance)

**+41 848 724 144 Asistenca**

**Ndihma mjekësore në rast aksidenti jashtë vendit.**

**SUVA**





[www.suva.ch](http://www.suva.ch)